

PLANIFIKIMI I BAZUAR NË LAGJE/ KOMUNITET MITROVICË JUGORE

RAPORT MBI PROJEKTIN



INCLUSIVE DEVELOPMENT PROGRAMME
PROGRAMI PËR ZHVILLIM GJITHËPËRFSHIRËS
PROGRAM SVEOBUHVATNOG RAZVOJA

Implementuar nga:



Financuar nga:

SWEDISH DEVELOPMENT
COOPERATION



United Nations Human Settlements Programme (UN-Habitat)
Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës
Ndërtesa e Qeverisë “Rilindja” Kati 10, 10000 Prishtinë, Kosovë
www.unhabitat.org
www.unhabitat-kosovo.org

Fotografitë, hartat dhe diagramet e përdorura në këtë raport janë pronë e UN-Habitat Kosova, nëse nuk është cituar ndryshe. Ato mund të riprodhohen me kushtin që burimi të shtypet me fotografitë, hartat ose diagramet ©UN-Habitat Kosova.

© UN-Habitat Kosovo.
Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2020
Kopertinat © UN-Habitat

FALËNDERIMET

AUTORE KRYESORE:

Fjollë Caka

RECESIONI:

Gwendoline Menetrier, Zana Sokoli

KONTRIBUES KRYESORË:

Zana Sokoli, Denis Dalladaku

KONTRIBUES TË TJERË:

Aida Krasniqi, Arbër Hasimja, Arta Bytyqi, Katarina Palushaj, Modest Gashi, Kenan Beqiri, Hana Gjokolli

FALËNDERIM TË VEÇANTË PËR PARTNERËT TANË:



UN Volunteers për ofrimin e UN Vullentares së komunitetit për projektin e planifikimit me bazë në komunitet/lagje.



Komunën e Mitrovicës Jugore dhe **Kolegjin UBT** (Instituti Arsimit i Mësimit të Lartë) për bashkëpunimin në zbatimin me sukses të Punëtorisë së Dizajnit dhe Zhvillimit Urban në Mitrovicën Jugore, si pjesë e projektit për planifikim me bazë në komunitet/lagje.

Në veçanti, falenderojnë **Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim (QBMK) “Nëna Tereze”, OJQ “7 arte”,** si dhe **Qendrën Burimore RADC** për sigurimin e hapësirës për realizim të punëtorisë. Falënderime të veçanta për folësit tanë mysafirë nga **OJQ ‘EC Ma Ndryshe’ Prizren** dhe **OJQ ‘Syri i Vizionit’ Pejë** për ndarjen e projekteve të tyre të bazuara në komunitet me pjesëmarrësit e punëtorisë sonë. Gjithashtu, falenderojnë anëtarët e Grupit Punues, të përbërë nga zyrtarë të Komunës së Mitrovicës Jugore, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare (**Danish Refugee Council – DRC**) dhe jo-qeveritare (**ZRRAM, PRAM, GAIA, CDO**), përfaqësuesin e **N.P.K. Tregu i Gjelbër**, drejtorin e QBMK “Nëna Tereze”, përfaqësuesit e lagjeve, si dhe hisedarë të tjerë që mbështetën dhe kontribuan në realizimin e projektit përmes dhënies së komenteve dhe sugjerimeve të tyre. Në fund, falenderojnë **studentët** që morrën pjesë në punëtori, për përkushtimin dhe kreativitetin e tyre të pakursyer në zhvillimin e ideve/sugjerimeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të lagjeve të përfshira në zonën e projektit në Mitrovicën Jugore.

PËRMBAJTJA

Lista e Shkurtesave	i
Lista e Figurave	i
Lista e Tabelave	ii
1. HYRJE	2
2. RRETH PROJEKTIT	3
Zona e Projektit	5
Zona 1 – Zhabari i Poshtëm dhe Liqeni Artificial	7
Zona 2 – Lagjja Rome, Fidanishte	8
Zona 3 – Fidanishte dhe Ilirida	9
Zona 4 – Qendra	9
Grupi Punues	14
Nevojat, çështjet dhe mundësitë për zhvillim të lagjeve	14
3. PUNËTORIA PËR DIZAJN DHE ZHVILLIM URBAN	18
4. REZULTATET E PUNËTORISË	24
Grupi 1 "Të gjitha rrugët të dërgojnë tek lumi"	27
Grupi 2 "Një vendi i mirë për t'u rritur"	29
Grupi 3 "Zemra dhe mendja e gjelbër e Mitrovicës"	31
Grupi 4 "Qyteti gjithëpërfshirës"	33
Grupi 5 "Qyteti i hapur"	35
Programi i integruar për zhvillim socio-ekonomik të lagjes	37
Konsultimi i propozimeve të studentëve me komunitetet e lagjeve dhe hapat e radhës	39
5. SHTOJCAT	43
Lista e anëtarëve të Grupit Punues	43
Lista e Grupit Mbështetës të Projektit	43
Lista e Grupit Mbështetës të Punëtorisë	44
Lista e prezentuesëve të punëtorisë	44
Lista e pjesëmarrësve në punëtori	44
Agjenda e punëtorisë	45
Konceptet fillestare të studentëve	48
Panelet finale të studentëve	51
6. REFERENCAT	61
7. PUBLIKIME/VEGËZA TË TJERA RELEVANTE	61

LISTA E SHKURTESAVE

3R	Reduce, Reuse, Recycle
CBM	Community Building Mitrovica
CDO	Civil Development Organization
DRC	Danish Refugee Council
IIK	Instrumenti për Investime Kapitale
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
OZHQ	Objektivi për Zhvillim të Qëndrueshëm
PBK	Planifikimi i Bazuar në Lagje/Komunitet
PPP	Partneritet Publiko Privat
PRAM	Përparimi Rinor i Ashkalive të Mitrovicës
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
QBMK	Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
RADC	Roma and Ashkalija Documentation Center (Qendra Burimore)
SIDA	Ajencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
ZRRAM	Zëri i Rinisë Rom dhe Ashkali Mitrovicë

LISTA E FIGURAVE

FIGURA 1. Skema e procesit të projektit për PBK.	3
FIGURA 2. Foto nga terreni.	5
FIGURA 3. Zona e projektit për PBK.	6
FIGURA 4. Zhvillimet në zonën e projektit për PBK.	6
FIGURA 5. Ndarja e zonave të projektit për PBK.	7
FIGURA 6. Zona 1 - Zhabari i Poshtëm dhe Liqeni Artificial.	7
FIGURA 7. Zona 1 - Zhabari i Poshtëm.	8
FIGURA 8. Zona 1 - Liqeni Artificial.	8
FIGURA 9. Zona 2 - Lagjja Rome, Fidanishte.	8
FIGURA 10. Zona 2 - Lagjja Rome.	8
FIGURA 11. Zona 3 - Fidanishte dhe Ilirida.	9
FIGURA 12. Zona 3 - Foto nga terreni.	9
FIGURA 13. Zona 4 - Qendra.	9
FIGURA 14. Zona 4 - Foto nga terreni.	9
FIGURA 15. Kualiteti i shërbimeve publike.	10
FIGURA 16. Mobiluari Urban.	10
FIGURA 17. Vlerësimi i sigorisë dhe komfortit.	11
FIGURA 18. Shfrytëzueshmëria dhe aktivitetet.	11
FIGURA 19. Shfrytëzueshmëria dhe aktivitetet në tregun e gjelbër.	12
FIGURA 20. Vlerësimi i qasjes.	12
FIGURA 21. Liqeni artificial.	13

FIGURA 22. Sheshi “Mehë Uka”.	13
FIGURA 23. Parku, mbrapa Komunës.	13
FIGURA 24. Rezultatet nga fokus grupet me të rinjtë në Lagjen Rome.	14
FIGURA 25. Rezultatet nga fokus grupet me gra në Lagjen Rome.	15
FIGURA 26. Rezultatet nga fokus grupet me burra në Lagjen Rome.	15
FIGURA 27. Procesi i organizimit të Punëtorisë për Dizajn dhe Zhvillim Urban.	18
FIGURA 28. Pamje gjatë punëtorisë nga takimi me Grupin Punues (lartë majtas), takimi me OJQ-të (lartë djathtas), vizita në terren (poshtë majtas) dhe nga ligjëratat (poshtë djathtas).	19
FIGURA 29. Pamje gjatë fjalëve hyrëse, ligjëratave dhe prezantimeve publike.	20
FIGURA 30. Pamje nga shfaqjet e filmave dokumentarë në hapësirën e OJQ “7 arte”.	21
FIGURA 31. Prezantimi/ekspozimi i punimeve të studentëve në QBMK “Nëna Tereze”.	21
FIGURA 32. Prezantimi/ekspozimi i punimeve të studentëve në “Ditën Botërore për Planifikim të Qyteteve” në hapësirat e ISP/MESP në Prishtinë.	22
FIGURA 33. Procesi i vizionimit dhe planifikimit sipas metodologjisë së UN-Habitat Kosovo.	23
FIGURA 34. Pjesëmarrësit e punëtorisë.	24
FIGURA 35. Fotografi gjatë punëtorisë së studentëve.	25
FIGURA 36. Vizionet e grupeve.	26
FIGURA 37. Skema e Vizionit të Grupit 1.	28
FIGURA 38. Masterplani i propozuar nga Grupi 1.	28
FIGURA 39. Skema e Vizionit të Grupit 1.	30
FIGURA 40. Masterplani i propozuar nga Grupi 1.	30
FIGURA 41. Skema e vizionit të Grupit 3.	32
FIGURA 42. Masterplani i propozuar nga Grupi 3.	32
FIGURA 43. Skema e vizionit të Grupit 4.	34
FIGURA 44. Masterplani i propozuar nga Grupi 4.	34
FIGURA 45. Skema e vizionit të Grupit 5.	36
FIGURA 46. Masterplani i propozuar nga Grupi 5.	36
FIGURA 47. Prezantimi i sugjerimeve të studentëve në Lagjen Rome.	39
FIGURA 48. Prezantimi i sugjerimeve të studentëve në Iliridë, Fidanishte e Qendër.	40

LISTA E TABELAVE

TABELA 1. Fazat dhe aktivitetet e projektit për PBK.	4
TABELA 2. Vlerat dhe mangësitë e zonës së projektit të identifikuar nga Grupi Punues.	16
TABELA 3. Mundësitë për zonën e projektit të identifikuar nga Grupi Punues.	17
TABELA 4. Përfitimet nga Punëtorja për Dizajn dhe Zhvillim Urban.	22
TABELA 5. Vlerat dhe kufizimet e lagjeve të identifikuar nga Grupi 1.	27
TABELA 6. Mundësitë dhe prioritetet e lagjeve të identifikuar nga Grupi 1.	27
TABELA 7. Vlerat dhe kufizimet e lagjeve të identifikuar nga Grupi 2.	29
TABELA 8. Mundësitë dhe prioritetet e lagjeve të identifikuar nga Grupi 2.	29
TABELA 9. Vlerat dhe kufizimet e lagjeve të identifikuar nga Grupi 3.	31
TABELA 10. Mundësitë dhe prioritetet e lagjeve të identifikuar nga Grupi 3.	31
TABELA 11. Vlerat dhe kufizimet e lagjeve të identifikuar nga Grupi 4.	33
TABELA 12. Mundësitë dhe prioritetet e lagjeve të identifikuar nga Grupi 4.	33
TABELA 13. Vlerat dhe kufizimet e lagjeve të identifikuar nga Grupi 5.	35
TABELA 14. Mundësitë dhe prioritetet e lagjeve të identifikuar nga Grupi 5.	35
TABELA 15. Ndikim i sugjerimeve hapësinore në aspektin social dhe ekonomik.	38

Raport mbi projektin



HYRJE

Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës, i implementuar bashkërisht nga UN-Habitat, Community Building Mitrovica (CBM) dhe PAX dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, synon të lehtësojë përafrimin e shtatë komunave veriore të Kosovës me kornizën e planifikimit në mbarë Kosovën, të forcojë kontratën shoqërore përmes mobilizimit të shoqërisë civile dhe dialogut publik, si dhe të nxisë integrimin përmes dialogut dhe bashkëpunimit lokal-qendror dhe ndër-komunal (përfshirë përmirësimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve). Në kuadër të Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës në **Komunën e Mitrovicës Jugore**, UN-Habitat-i mbështet proceset dhe dokumentet e planifikimit hapësinor (siç janë Plani Zhvillimor Komunal, Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban dhe Baza e Integruar e të Dhënave), si dhe një projekt që zhvillohet nga ‘poshtë-lartë’ – i ashtuquajtur Planifikimi i Bazuar në Lagje/Komunitet.

Projekti për Planifikimin e Bazuar në Lagje/Komunitet (PBK) u inicua në vitin 2017 si kërkesë nga Komuna e Mitrovicës Jugore, e cila identifikoi një zonë përgjatë bregut të lumit Ibër (brenda territorit të saj urban) si zonë strategjike për zhvillimin e komunës. Lagjet e përfshira në këtë zonë janë lagja Fidanishte, Rome, Ilirida, Qendra dhe Zhabari i Poshtëm. Secila nga këto lagje është e ndryshme për nga karakteristikat hapësinore, përmbajtësore dhe socio-ekonomike; megjithatë, zhvillimet e hovshme të kohëve të fundit në tërë zonën janë duke ndikuar në secilën prej tyre. Si pasojë, këto zhvillime duhet të koordinohen dhe orientohen drejt një vizioni të përbashkët zhvillimor, ashtu që secila lagje të përfitojë e jo të penalizohet nga to.

Me qëllim të zhvillimit më të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të lagjeve, komunitetet e tyre duhet domosdo të përfshihen në proceset e diskutimit dhe planifikimit. Vetëm duke përfshirë zërat e banorëve rreth nevojave dhe kërkesave përkatëse do të mund të krijohet një vizion i përbashkët për të ardhmen, i bazuar në vlera dhe prioritete të lagjeve, i cili përveç se do të ofrojë zgjidhje reale dhe lehtësisht të zbatueshme, do të forcojë edhe ndjenjën e përkatësisë, pronësisë dhe përgjegjësisë të komuniteteve lokale.

Për vlerësimin e gjendjes ekzistuese dhe zhvillimin e ideve të mundshme për zhvillim hapësinor dhe socio-ekonomik të zonës u organizua **Punëtorja për Dizajn dhe Zhvillim Urban**. Gjatë kësaj punëtorie 24 studentë të fushave të ndryshme (arkitekturë, planifikim urban, mjedis dhe ekonomi) zhvilluan pesë koncepte/skenare të ndryshme për zhvillimin hapësinor dhe socio-ekonomik të lagjeve të përfshira, nën asistimin e stafit të UN-Habitatit me mbështetje nga Kolegji UBT dhe Komuna e Mitrovicës Jugore. Konceptet e tyre u zhvilluan duke marrë parasysh bashkëbisedimet me Grupin Punues dhe me organizatat e shoqërisë civile që punojnë me komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane në Lagjen Rome, vizitat në terren, si dhe hulumtimet paraprake të bëra nga UN-Habitat dhe CBM.

Ky raport shtjellon pesë propozime të ndryshme të zhvilluara nga studentët me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të zonës. Raporti i dorëzohet Komunës së Mitrovicës Jugore për t’u konsideruar gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Mitrovicës Jugore për periudhën 2020-2028+, si dhe cikleve buxhetore përkatëse në rast të integritetit të ideve të sugjeruara.

RRETH PROJEKTIT

Projekti për Planifikimin e Bazuar në Lagje/ Komunitet ka për qëllim të rrisë dialogun ndërmjet qeverisë lokale dhe qytetarëve duke fuqizuar qytetarët (veçanërisht grupet e marginalizuara) dhe shoqërinë civile të marrin pjesë në proceset e planifikimit dhe zhvillimit hapësinor të qeverisjes lokale. Angazhimi i komuniteteve lokale dhe bashkëpunimi me ta në proceset e planifikimit dhe zhvillimit hapësinor jo vetëm se do të kontribuojë në adresimin më të mirë të çështjeve dhe nevojave të komuniteteve të lagjeve të përfshira në projekt, njëkohësisht do të kontribuojë edhe në rritjen e kapaciteteve planifikuese të komunës duke shtuar perspektivën e planifikimit nga ‘poshtë-lartë’.

Rezultatet e pritura të projektit përfshijnë:

- Hartimin e masterplanit për zhvillimin hapësinor të zonës së projektit,
- Hartimin e programit për zhvillimin socio-ekonomik të zonës së projektit,
- Përfshirjen e tyre në dokumentet e planifikimit dhe në ciklin buxhetor të komunës.

Me rastin e inicimit të projektit nga Komuna e Mitrovicës Jugore në vitin 2017, u përcaktua edhe qasja dhe metodologjia e realizimit të projektit. Metodologjia e ndjekur për implementimin e projektit përfshinë arritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me komunën, themelimin e Grupit Punues, hulumtimet në terren, vlerësimin e gjendjes ekzistuese, dhënieve të sugjerimeve/ideve, si dhe shtytjen e proceseve drejt zhvillimit të ardhshëm hapësinor dhe socio-ekonomik të lagjeve në mënyrë më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Si proces, projekti u zhvillua në katër faza, të cilat janë Mobilizimi, Qasja, Planifikimi dhe Implementimi.




FIGURA 1. Skema e procesit të projektit për PBK.

Përkundër fillimit të aktiviteteve në vitin 2017, me rastin e ndryshimeve në strukturën e drejtorive komunale (përfshirë Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm si dhe Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë), të përfaqësuesve zyrtarë të lagjeve të përfshira në projekt, si dhe zhvillimeve të tjera në qytet që ndikonin në zonën e përfshirë, projekti u ndërpre për një kohë deri sa u rikonfirmua vullneti komunal për vazhdimin e tij. Si pasojë, projekti u rikonceptua dhe vazhdoi tutje në vitin 2019. Disa nga ndryshimet kyçe të ndërmarra në projekt përfshijnë përditësimin e Grupit Punues (duke u zgjeruar në aspektin e përfaqësimit të përfaqësuesve të lagjeve dhe organizatave joqeveritare që punojnë me komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, si dhe ato të fokusuar në çështje mjedisore),

organizimin e Punëtorisë për Dizajn dhe Zhvillim Urban në bashkëpunim me Komunën e Mitrovicës Jugore dhe Kolegjin UBT (me synim të përfitimit të përbashkët nga bashkëpunimi ndër-institucional vendor), si dhe angazhimi i studentëve ¹ (të arkitekturës, planifikimit urban, mjedisit dhe ekonomisë) në hartimin e masterplanit dhe programit zhvillimor socio-ekonomik të zonës së projektit përmes punëtorisë, në mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme planifikuese dhe dizajnuese përbrenda komunës dhe me qëllim të mbledhjes së më shumë ideve/sugjerimeve kreative për zonën e projektit. Fazat e projektit dhe aktivitetet e ndërlidhura (së bashku me periudhën kohore të realizimit) të tyre janë paraqitur në tabelën e më poshtme.

Fazat	Aktivitetet Kyçe	Periudha
1. Mobilizimi: <i>Inicimi i projektit</i>	<ul style="list-style-type: none"> Marrëveshja me Komunën e Mitrovicës Jugore Përcaktimi i kufijve të zonës së projektit Identifikimi i hisedarëve dhe palëve të interesit (<i>përditësuar</i>) Përcaktimi i Grupit Punues (<i>përditësuar</i>) 	<p>Mesi i 2017</p> <p>Mesi i 2017, përditësuar në Prill - Gusht, 2019</p>
2. Qasja: <i>Analiza e kontekstit</i>	<ul style="list-style-type: none"> Realizimi i fokus grupeve dhe pyetësorëve me banorët e Lagjes Rome (në grupe të ndara: burra, gra, të rinjë) Identifikimi i çështjeve, nevojave dhe prioritetëve në zonë Hulumtimi në literaturë Marrja e sugjerimeve të Grupit Punues rreth vlerave/aseteve, çështjeve dhe mundësive për zhvillim në zonën e projektit 	<p>Gusht - Tetor, 2017</p> <p>Prill - Gusht, 2019</p> <p>Shtator, 2019</p>
3. Planifikimi: <i>Zhvillimi i masterplanit dhe programit socio-ekonomik</i>	<ul style="list-style-type: none"> Planifikimi dhe organizimi i Punëtorisë për Dizajn dhe Zhvillim Urban Rekrutimi i studentëve të Kolegjit UBT dhe universiteteve të tjera në Kosovë Mbajtja e punëtorisë (së përcjellur me ligjërata, prezantime, punë në grupe, diskutime, vizita në terren, takime me Grupin Punues dhe shoqërinë civile aktive në lagje) Vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe zhvillimi i pesë koncepteve/propozimeve të ndryshme për zhvillim hapësinor dhe socio-ekonomik të zonës Ekspozimi/prezantimi i pesë koncepteve të studentëve (tek Grupi Punues, shoqëria civile aktive në lagje dhe palët tjera të interesit) Prezantimi i koncepteve të studentëve tek komunitetet e lagjeve përkatëse me qëllim të marrjes së komenteve, pëlqimeve dhe sugjerimeve të tyre 	<p>Prill - Shtator, 2019</p> <p>Shtator, 2019</p> <p>Tetor - Nëntor, 2019</p> <p>Nëntor, 2019</p> <p>Dhjetor, 2019</p>
4. Implementimi: <i>Përfshirja e propozimeve në dokumentet e planifikimit</i>	<ul style="list-style-type: none"> Përfshirja e propozimeve të studentëve dhe të komuniteteve për zhvillim të zonës në Planin Zhvillimor Komunal Përfshirja e propozimeve me prioritet në lagje në ciklin buxhetor të komunës Gjetja e donatorëve potencial për zbatim të ideve 	<p>Janar-Shkurt, 2020</p> <p>Prill, 2020</p>

TABELA 1. Fazat dhe aktivitetet e projektit për PBK.

¹ Angazhimi i të rinjëve në Komunën e Mitrovicës Jugore në matjet e vëllimit të trafikut gjatë procesit të hartimit të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban është vlerësuar si proces i suksesshëm, prandaj edhe është konsideruar angazhimi i studentëve në punëtorinë e projektit për planifikim në lagje.

Zona e projektit

Zona e projektit u përcaktua nga Komuna e Mitrovicës Jugore në bashkëpunim me UN-Habitat dhe CBM, bazuar në kriteret përcaktuese për përzgjedhjen e lagjeve të paraqitura në matricën e dizajnuar nga UN-Habitat. Kjo matricë merr në konsideratë disa kriteret, ndër të cilat përfshihen rregullimi/trajtimi i lagjes/zonës në plane ekzistuese urbane, investimet në të, struktura urbane, infrastruktura urbane (rrjeti rrugor dhe furnizimi me ujë e kanalizim), pronësia, resurset natyrore, fatkeqësitë natyrore, ndotja (e ajrit, tokës, ujit dhe ngazhurma), përmbajtja demografike (grupmoshat, varfëria dhe pabarazia), organizimi i komunitetit, siguria urbane, shërbimet publike (arsimimi, shëndetësia, kultura dhe sporti, hapësirat publike, transporti publik), kohezioni dhe konfliktet në komunitet, si dhe ekonomia.

Bazuar në këto kriteret dhe në potencialin për zhvillim strategjik, komuna përcaktoi një zonë me një sipërfaqe prej rreth 2 km², e cila shtrihet në zonën urbane të Mitrovicës Jugore, përgjatë bregut jugor të lumit Ibër. Kjo zonë përfshinë lagjen Fidanishte dhe Rome (në pjesën qendrore), Iliridën (në juglindje), Qendrën (në veriperëndim) dhe Zhabarin e Poshtëm (në jugperëndim). (shih Fig. 3)

Zhvillimet e fundit në zonë kanë krijuar një përzierje të shfrytëzimeve të tokës, duke përfshirë njësi banimi (shtëpi individuale, banesa, dhe banesa sociale), institucione publike (p.sh. Shkolla Fillore “Migjeni”, Shkolla e Mesme Teknike “Arkitekt Sinani”, “Shkolla Amerikane”, Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nëna Tereze”, si dhe Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”), aktivitete ekonomike (p.sh. Tregu i Gjelbër në Qendër, Inkubatori i Biznesit Social në Lagjen Rome), objekte kulturore (p.sh. objekti multifunksional i ndërtuar nga Bashkimi Europian afër urës kryesore të lumit Ibër) dhe zona rekreative (p.sh. stadiumet “Adem Jashari” dhe “Fatime Gjaka”, OMNI Sport, Liqeni Artificial dhe Aqua Parku). (shih Fig. 4)

Përkundër larmisë së funksioneve në lagje, dallimet hapësinore janë akoma të dukshme. Lagjja Rome, Aqua Parku dhe kampusi universitar zhvillohen në afërsi, por megjithatë janë shumë të izoluara nga njëra-tjetra. Duke marrë parasysh zhvillimet e ardhshme të planifikuara brenda lagjes, siç është hapja e segmenteve të reja rrugore dhe ndërtimi i një hoteli luksoz brenda Aqua Parkut, është thelbësore që të shmanget dhe të adresohet sa më parë thellimi i pabarazive hapësinore dhe segregimi social.



FIGURA 2. Foto nga terreni.



FIGURA 3. Zona e projektit për PBK.



FIGURA 4. Zhvillimet në zonën e projektit për PBK.

Për qëllim të këtij projekti, lokacioni i trajtuar është ndarë në 4 zona (të paraqitura në vijim):

a) Zona 1, e cila përfshinë Zhabarin e Poshtëm dhe Liqenin Artificial,

b) Zona 2, ku hyn Lagjja Rome, pishina Aqua Park dhe pjesa veriperëndimore e Fidanishtes.

c) Zona 3, e përbërë nga pjesa juglindore e Fidanishtes dhe Ilirida, si dhe

d) Zona 4, ku hyn një pjesë e Qendrës.



FIGURA 5. Ndarja e zonave të projektit për PBK.

Zona 1 – Zhabari i Poshtëm dhe Liqeni Artificial

Zhabari i Poshtëm karakterizohet me banim të ulët individual dhe infrastrukturë të mirë rrugore. Pjesë më të dalluara në lagje janë Liqeni Artificial dhe Stadiumi “Adem Jashari”. Liqeni shtrihet përgjatë rrjedhës së lumit Ibër dhe fshatrave: Suhodolli i Poshtëm dhe i Epërm, Zhabar i Poshtëm deri në Gushac dhe Vinarç të Poshtëm. Ai ka një gjatësi prej 1.8 km, gjerësi rreth 150 m dhe thellësi 4 m. Finalizimi i këtij liqeni është bërë në vitin 2017 me donacion nga Bashkimi Evropian. Në përgjithësi kjo zonë perceptohet e sigurt, me infrastrukturë të mirë.



FIGURA 6. Zona 1 - Zhabari i Poshtëm dhe Liqeni Artificial.



FIGURA 7. Zona 1 - Zhabari i Poshtëm.



FIGURA 8. Zona 1 - Liqeni Artificial.

Zona 2 – Lagjja Rome, Fidanishte

Pjesa veriperëndimore e Fidanishtes, e shtrirë përgjatë lumit Ibër, karakterizohet me Lagjen (Mahallën) Rome. Para vitit 1999, kjo lagje u zhvillua si një vendbanim joformal, i cili shtrihej nga stadiumi i vjetër i qytetit deri tek ura e Suhadollit (deri në bregun e lumit Ibër) (Kuvendi Komunal i Mitrovicës & Linprojekt, 2012). Rindërtimi i lagjes filloi në vitin 2007 pas programeve të rivendosjes dhe rindërtimit nga Këshilli Danez i Refugjatëve (DRC), Ndihma e Kishës Norvegjeze (NCA) dhe Mercy Corps (DRC, 2013; ERRC, 2007). Në vitin 2007, DRC asistoi në rindërtimin e disa (54) shtëpive private (ku u strehuan 56 familjeve me të drejta pronësore) (DRC, 2013). Ndërsa, në vitin 2015, NCA dhe Mercy Corps ndërtuan edhe 6 ndërtesa shumëbanesore (që strehuan 72 familje me të drejtë të shfrytëzimit të banesave) dhe 150 shtëpi në varg. Lagjja përmban edhe një Inkubator të Biznesit Social, një Qendër Burimore për Mësim (RADC), si dhe një xhami.

Familjet që jetojnë në lagje përbëhen nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptianë të zhvendosur nga kampet e kontaminuara me plumb të Çesmin Lug dhe Osterode (me kushte jetese nën standarde) në Mitrovicën e Veriut ose ato në Mal të Zi (OSBE, 2012a; Insajderi, 2017). Këto familje kanë disa anëtarë, e disa prej tyre janë familje me mbi 10 anëtarë (Insajderi, 2017). Deri në dhjetor të vitit 2011, lagjja kishte 104 familje (OSBE, 2012a), ndërsa sot numri i tyre është rritur dukshëm.

Në përgjithësi, lagjja ka mungesë të mirëmbajtjes së hapësirave publike (p.sh. mungesa e mobiluarit urban në parqe), qasje jo të lehtë përmes rrugëve të përbashkëta, si dhe mungesë të sigurisë për shkak të diskriminimit dhe dhunës në baza gjinore.



FIGURA 9. Zona 2 - Lagjja Rome, Fidanishte.



FIGURA 10. Zona 2 - Lagjja Rome.

Zona 3 – Fidanishte dhe Ilirida

Zona 3, ku përfshihen pjesë të Fidanishtes dhe Iliridës, dallohet me banim të ulët dhe të mesëm, megjithatë rishtazi ka marrë hov edhe zhvillimi i banimit të lartë. Fidanishtja karakterizohet me përmbajtje të lartë të institucioneve arsimore, ndër të cilat përfshihen edhe kampusi i ri universitar i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini“, dhe Shkolla Amerikane.



FIGURA 11. Zona 3 - Fidanishte dhe Ilirida.

Në përgjithësi lagjja është e lidhur mirë me pjesët tjera të qytetit, megjithatë ka mungesë të sigurisë në trafik, mungesë të shtigjeve për bicikleta, si dhe qasje jo të lehtë të personave me aftësi të kufizuara fizike apo nënave me karroca.



FIGURA 12. Zona 3 - Foto nga terreni.

Zona 4 – Qendra

Zona e Qendrës dallohet me përmbajtje më të madhe të objekteve publike, banim të mesëm dhe të lartë, si dhe aktivitete komerciale e rekreative. Vende më karakteristike në këtë zonë janë ura kryesore e lumit Ibër së bashku me shetitoren përgjatë bregut jugor të lumit, ndërtesa e Komunës së Mitrovicës Jugore, Xhamia Isa Beg, Tregu i Gelbër, Stadiumi

“Fatime Gjaka”, ndërtesa e OMNI Sportit, Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim (QBMK) “Nëna Tereze”, biblioteka e qytetit, etj. Kjo pjesë përmban edhe kafene të shumta të frekuentuara nga të rinjtë e vendit. Në përgjithësi zona konsiderohet e sigurt dhe me infrastrukturë të mirë. Megjithatë, qasja për biçikleta nuk është e lehtë dhe e sigurt.




FIGURA 13. Zona 4 - Qendra.



FIGURA 14. Zona 4 - Foto nga terreni.




FIGURA 15. Kualiteti i shërbimeve publike.




FIGURA 16. Mobiluari Urban.




FIGURA 17. Vlerësimi i sigurisë dhe komfortit.




FIGURA 18. Shfrytëzueshmëria dhe aktivitetet.




FIGURA 19. Shfrytëzueshmëria dhe aktivitetet në tregun e gjellbër.




FIGURA 20. Vlerësimi i qasjes.




FIGURA 21. Liqeni artificial.



FIGURA 22. Sheshi "Mehë Uka".



FIGURA 23. Parku, mbrapa Komunës.

Grupi punues

Grupi Punues i projektit përbëhet nga zyrtarë të komunës të drejtorive të ndryshme, përfaqësues të komuniteteve/lagjeve të përfshira në zonë, përfaqësues të shoqërisë civile aktive në lagje (përfshirë DRC, ZRRAM, PRAM, RADC, CDO, GAIA), si dhe përfaqësues të Tregut të Gjelbër (si hapësirë ekonomike e zonës) dhe të Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nëna Terezë” (si institucion arsimor). Ky grup ka rol përfaqësues, avokues dhe këshillues. Lista e plotë e Grupit Punues është në Shtojca.

Nevojat, çështjet dhe mundësitë për zhvillim të lagjeve

Identifikimi i nevojave të lagjeve u bë në bazë të takimeve me fokus grupe të ndara me burra, gra dhe të rinjtë të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptianë të Lagjes Rome (të mbajtura në

vitin 2017) dhe me marrjen e komenteve nga anëtarët e Grupit Punues (në vitin 2019) për të gjithë zonën e projektit.

Sipas fokus grupeve në Lagjen Rome, banorët në përgjithësi kanë nevojë për përmirësim të shërbimeve infrastrukturore dhe publike, më shumë vendtakime (hapësira publike dhe të gjelbërta), si dhe më shumë mundësi punësimi. Tek të rinjtë theksohet nevoja për një qendër rinore për trajnime dhe aktivitete kulturore. Ndërsa të rriturit shprehin nevojën për ngritjen e sigurisë në lagje, përkatësisht ngritjen e sigurisë në rrugë më qëllim të qasjes së lehtë dhe lëvizjes së lirë të grave (p.sh. përmes shtimit të ndriçimit dhe sinjalizimit në rrugë), si dhe ndalimin e dhunës ndërmjet komuniteteve multi-etnike (përmes shtimit të prezencës së policisë). Nevojat e komuniteteve në Lagjen Rome, sipas fokus grupeve, janë paraqitur në skemat e mëposhtme.




FIGURA 24. Rezultatet nga fokus grupet me të rinjtë në Lagjen Rome.




FIGURA 25. Rezultatet nga fokus grupet me gra në Lagjen Rome.



FIGURA 26. Rezultatet nga fokus grupet me burra në Lagjen Rome.

Në anën tjetër, Grupi Punues ka identifikuar asetet/vlerat dhe problemet/mangësitë për zhvillim të lagjes (TABELA 2), si dhe

mundësitë dhe prioritetet për zonën e projektit (TABELA 3)

Vlerat/Asetet	Problemet/Mangësitë
<p>Ilirida: Rrugët e asfaltuara dhe të ndriçuara; Prezenca e pronave komunale; Fondet nga MMPH për mirëmbajtjen e Liqenit Artificial; Fidanishte: Prezenca e institucioneve arsimore të të gjitha niveleve (fillor, mesëm, lartë); Zhvillimi i ndërtimit të lartë dhe mundësitë për zhvillimin e bizneseve; Lagjja Rome: Investimet e reja në lagje; Zhabar i Poshtëm: Rrugët e gjera dhe terreni i rrafshët (i përshtatshëm për biçikleta); Qendra: Prezenca e institucioneve arsimore dhe kulturore; Prezenca e Tregut të Gjelbër me infrastrukturë adekuate dhe hapësirë të mjaftueshme për të gjithë</p>	<p>Ilirida: Qasja jo e lehtë për persona me aftësi të kufizuara (mungesa e pjerrinave dhe trotuareve të përshatshme); Mungesa e shtigjeve për çiklistë; Zënia e trotuareve nga automjetet; Mosmirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta dhe këndet e lojërave për fëmijë; Mungesa e çerdhes për fëmijë; Lagjja Rome: Rrethoja jo aq e kënaqshme e lagjes; Mungesa e fushave sportive; Mungesa e qendrave rinore për punësim dhe rekreacion; Mungesa e integritit të lagjes në entet arsimore (përfshirë QBMK “Nëna Terezë”) Zhabari i Poshtëm: Mungesa e sigurisë gjatë natës (dominion banimi individual dhe ndriçimi është i pamjaftueshëm); Mungesa e hapësirave për persona të moshuar; Mungesa e pjerrinave për persona me aftësi të kufizuara dhe nëna me karroca; Mungesa e qasjes në transport urban që lidhë me qendrën e qytetit; Qendra: Prezenca e tregtarëve të druve dhe të pulave në rrugë në afërsi të tregut (që ndikon në ndotjen e mjedisit dhe mungesën e sigurisë ushqimore); Rrugët e zëna nga shitës ambulatorë që pengojnë sigurinë në rrugë (p.sh. qasjen e zjarrëfikësave).</p>

TABELA 2. Vlerat dhe mangësitë e zonës së projektit të identifikuar nga Grupi Punues.

Fushat tematike/Aspektet	Mundësitë
Liçeni Artificial	<ul style="list-style-type: none"> - Lidhja e shetitores/shtegut për këmbësorë përgjatë lumit Ibër me Liçenin Artificial; - Mirëmbajtja e vazhdueshme e liçenit (me mundësi të angazhimit edhe të Shoqatës së Peshkatarëve).
Hapësirat publike dhe të gjelbërta	<ul style="list-style-type: none"> - Shtimi i shtigjeve për çiklistë dhe këmbësorë; - Hapja e fushave sportive dhe hapësirave të tjera publike (rrënimi i rrethojave të betonit); - Renovimi i parqeve ekzistuese në Lagjen Rome; - Krijimi i hapësirave të gjelbërta interaktive (të shfrytëzuara nga qytetarët për mbjellje të pemëve dhe perimeve); - Adaptimi/ripërdorimi i hapësirave publike dhe ndërtesave ekzistuese.
Tregu i Gjelbër	<ul style="list-style-type: none"> - Rifunksionalizimi i tregut duke i shtuar kafene dhe produkte artizanale/zejtare, - Aplikimi i sistemit të mbyllur (në mënyrë që të përdoret edhe gjatë stinës së dimrit), - Krijimi i ofertave më të mira për shfrytëzim të hapësirës nga shitës sezonal (jo të rregullt) të produkteve bujqësore; - Decentralizimi i tregut (krijimi i mini-tregjeve sezonale për secilën lagje ose i tregjeve mobile); - Lidhja e tregut në Mitrovicën Jugore me atë të Mitrovicës Veriore (përmes urës këmbësorike në lumin Ibër).
Aspekte të tjera që kontribuojnë në ngritjen e kualitetit të lagjeve	<ul style="list-style-type: none"> - Ngritja e sigurisë në rrugë (përmes dizajnit urban, shtimit të ndriçimit dhe sinjalzimit); - Përdorimi i materialeve lokale dhe ftuese në strukturën urbane; - Sigurimi i vazhdueshëm i ujit të pijshëm në lagje; - Krijimi i një qendre për reciklim të mbeturinave (plastikës) dhe për kompost të mbetjeve organike.

TABELA 3. Mundësitë për zonën e projektit të identifikuar nga Grupi Punues.

Nevojat, çështjet dhe mundësitë përbrenda zonës së projektit të identifikuar nga fokus grupet dhe Grupi Punues janë shqyrtuar edhe nga stafi i UN-Habitat dhe CBM, si dhe janë plotësuar edhe nga analizat e gjendjes faktike në terren (të bëra nga studentët gjatë Punëtorisë për Dizajn dhe Zhvillim Urban) dhe planet e

tjera të parapara për zonën (sipas Planeve Rregulluese Urbane paraprake apo konsultimeve me zyrtarë komunalë). Bazuar në këto të gjetura, janë zhvilluar edhe idetë/sugjerimet për zhvillim hapësinor dhe socio-ekonomik të zonës së projektit.

PUNËTORIA PËR DIZJAN DHE ZHVILLIM URBAN

Punëtorja për Dizajn dhe Zhvillimit Urban u organizua me qëllim të vlerësimit të gjendjes ekzistuese dhe zhvillimit të ideve/koncepteve të mundshme për zhvillim hapësinor dhe socio-ekonomik të zonës së projektit. Punëtorja u organizua bashkërisht nga partnerët e Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës (UN-Habitat,

CBM dhe PAX), Komuna e Mitrovicës Jugore, dhe UBT – Instituti i Arsimit të Lartë (Kolegji UBT), me mbështetjen e partnerëve të tjerë dhe palëve të tjera të interesuara. Ajo u mbajt në QBMK “Nëna Tereze” në lagjen Fidanishte në Mitrovicën Jugore, nga data 28 tetor deri më 1 nëntor 2019.




FIGURA 27. Procesi i organizimit të Punëtorisë për Dizajn dhe Zhvillim Urban.

Pjesëmarrësit e punëtorisë ishin gjithsej 24 studentë (lista në Shtojca) të fushave të ndryshme, përfshirë arkitekturën, planifikimin urban, mjedisin dhe ekonominë, 17 prej të cilëve nga Kolegji UBT dhe 7 të tjerë që u përzgjedhën përmes thirrjes së shpallur për aplikim. Punëtorja u shoqërua me takime me Grupin Punues, shoqërinë civile që merren me

komunitetet e Lagjes Rome (përfshirë DRC, PRAM, ZRRAM dhe RADC) dhe hisedarë të tjerë; ligjëratat/prezantime publike; vizita në terren për vlerësim të gjendjes aktuale; shfaqje filmike në lidhje me planifikimin dhe dizajnin urban; punë në grupe dhe diskutime; si dhe ekspozimi/prezantimi i rezultateve përfundimtare.



FIGURA 28. Pamje gjatë punëtorisë nga takimi me Grupin Punues (lartë majtas), takimi me OJQ-të (lartë djathtas), vizita në terren (poshtë majtas) dhe nga ligjëratat (poshtë djathtas).

Ligjëratat/prezantimet publike përfshinë:

- Fjalët hyrëse (nevojat dhe pritshmëritë) nga Z. Faruk Mujka (nënkryetari i Komunës së Mitrovicës Jugore), Z. Edmond Hajrizi (rektori i Kolegjit UBT), si dhe Znj. Gwendoline Mennetrier (udhëheqëse e UN-Habitat në Kosovë);
- Principet e planifikimit dhe dizajnit urban nga Binak Beqaj dhe Elvida Pallaska (profesorë të Kolegjit UBT);
- Proceset e vizionimit dhe planifikimit të bazuar në lagje në Kosovë nga Arijeta Himaduna (UN-Habitat);

- Qyteti Gjithëpërfshirës (Prizren) dhe roli i shoqërisë civile në përfshirjen e komunitetit në proceset e planifikimit hapësinor nga Valon Xhabali (OJQ “EC Ma Ndryshe”); si dhe
- Plani Rregullues Urban (Vendbanimi Joformal) Zatra (Pejë) dhe roli i shoqërisë civile në mbledhjen e të dhënave socio-ekonomike gjatë hartimit të planit nga Dukagjin Nishiqi (OJQ “Syri i Vizionit”).




FIGURA 29. Pamje gjatë fjalëve hyrëse, ligjëratave dhe prezantimeve publike.

Me qëllim të ekspozimit të studentëve ndaj njohurive dhe praktikave ndërkombëtare rreth planifikimit dhe dizajnit urban të qëndrueshëm, të drejtës mbi qytetin, aktivizmit qytetar, si dhe formave të ndryshme të ndikimit në komunitete përmes komponentës hapësinore, në mbërmeje u shfaqën edhe disa filma dokumentarë, fjalime dhe video të tjera në hapësirën e OJQ “7 arte”. Filmat dokumentarë dhe videot e tjera që ju shfaqën studentëve përfshinë:

- Urbanized, by Gary Hustwit, 2011;
- How to make an attractive city, the School of Life, 2015;
- The right to the city, UN-Habitat worldwide, 2016;
- It's our city. Let's fix it, talk by Alessandra Orofino, TED, 2014;
- Face 2 Face trailer, project by JR and Marco, 28millimeters, 2007.

Punimet e studentëve ishin paraparë të ekspozohen në ditën e fundit të punëtorisë



FIGURA 30. Pamje nga shfaqjet e filmave dokumentarë në hapësirën e OJQ “7 arte”.



FIGURA 31. Prezantimi/ekspozimi i punimeve të studentëve në QBMK “Nëna Tereze”.

(1 nëntor 2019) në hapësirën e Tregut të Gjelbër, mirëpo për shkak të kushteve jo të përshtatshme klimatike në ditën e ekspozitës, ato u prezantuan në QBMK “Nëna Tereze”. Për më tepër, punimet e tyre u prezantuan edhe në ngjarjen e organizuar për shënimin e “Ditës Botërore për Planifikim të Qyteteve” (8 nëntor 2019), me ç’rast studentët prezantuan para nivelit qendror dhe lokal (përfaqësues të komunave të ndryshme), akademisë, si dhe organizatave të tjera që merren me planifikim hapësinor. Kjo ngjarje, tema e së cilës ishte “Lagja”, u organizua nga Instituti për Planifikim Hapësinor (përbrenda MMPH) me mbështetje të Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës.

Përfitimet nga organizimi i punëtorisë ishin të shumfishta për të gjitha palët e përfshira. Në tabelën 4 janë paraqitur përfitimet për Komunën e Mitrovicës Jugore, komunitetet e lagjeve të zonës së projektit, si dhe studentët pjesëmarrës në punëtori.






FIGURA 32. Prezantimi/ekspozimi i punimeve të studentëve në “Ditën Botërore për Planifikim të Qyteteve” në hapësirat e IPH/MMPH në Prishtinë.

Hisedarët	Përfitimet
Komuna e Mitrovicës Jugore	<ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i duhur i çështjeve dhe nevojave të qytetarëve brenda lagjeve; - Mbledhja e ideve inovative për të mbështetur zhvillimin e lagjeve (përfshirë orientimet e zhvillimit hapësinor, mjedisin kualitativ, dizajnin urban dhe zhvillimin socio-ekonomik); - Potenciali për integrimin social të komuniteteve të etnive të ndryshme; - Reduktimi i pabarazive hapësinore; - Rritja e kënaqësisë së qytetarëve me punën e komunës.
Komunitetet e lagjeve	<ul style="list-style-type: none"> - Fuqizimi i komuniteteve lokale; - Identifikimi dhe kuptimi i duhur i çështjeve dhe nevojave të tyre në lagje; - Përfshirja në adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve të identifikuara në lagje; - Ndërtimi mbi vlerat/pikat e forta të lagjes; - Orientimi i zhvillimeve të ardhshme; - Llojllojshmëria e sugjerimeve dhe ideve për masterplanin hapësinor dhe programin e zhvillimit socio-ekonomik; - Rritja e mundësive socio-ekonomike brenda lagjes (p.sh. integrimi social, rivitalizimi i Tregut të Gjelbër, shfrytëzimi i Inkubatorit Social në lagjen rome etj.); - Rritja e cilësisë së mjedisit jetësor (p.sh. rrugët e sigurta për fëmijët, qasja e lehtë në shkolla, dyqane dhe qendra komunitare, lloje të ndryshme banimi).
Studentët pjesëmarrës	<ul style="list-style-type: none"> - Ekspozimi i studentëve në një rast studimor ekzistues përmes projektit për planifikim të bazuar në lagje/komunitet dhe rritja e aftësive të tyre gjatë planifikimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm të lagjeve; - Mundësia e diskutimit dhe planifikimit së bashku me hisedarë të ndryshëm në Mitrovicën Jugore; - Ekspozimi ndaj ligjëratave dhe dokumentarëve të ndryshëm rreth planifikimit me bazë në lagje/komunitet; - Përfshirja në zhvillimin e një masterplani me bazë në komunitet për zhvillim të qëndrueshëm hapësinor të zonës së projektit; - Përfshirja në zhvillimin e një programi gjithëpërfshirës për zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve që jetojnë në zonën e projektit; - Pajisja me certifikata/mirënjohje që dëshmojnë pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre në punëtori; - Ekspozimi i punimeve të tyre në ditën e fundit të punëtorisë në Mitrovicën Jugore, më 1 Nëntor, 2019; - të Planifikimit të Qyteteve, e cila organizohet më 8 Nëntor, 2019 nga MMPH/IPH me përkrahjen e Programit për Zhvillim Gjithëpërfshirës - Ekspozimi i punimeve të tyre në Kolegjin UBT

TABELA 4. Përfitimet nga Punëtorja për Dizajn dhe Zhvillim Urban.

VIZIONIMI



PROCESI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



FIGURA 33. Procesi i vizionimit dhe planifikimit sipas metodologjisë së UN-Habitat Kosovo.

Rezultatet e punëtorisë

Puna e studentëve u zhvillua në pesë grupe të përbëra nga studentë të fushave të përziera (arkitekturë, planifikim urban, mjedis dhe ekonomi), të udhëhequr nga stafi i UN-Habitat dhe të mbështetur nga Kolegji UBT dhe Komuna e Mitrovicës Jugore. Secili grup kishte së paku një student vendas, në mënyrë që të kuptohej dhe adresohet konteksti lokal sa më mirë. Bazuar në bashkëbisedimet e zhvilluara gjatë punëtorisë, vizitës në terren, si dhe hulumtimet paraprake në dizpozicion, studentët vlerësuan vlerat/asetet pozitive të

lagjeve, mangësitë dhe problemet/çështjet e tyre, ndikimet e zhvillimeve aktuale në lagje, si dhe nevojat e komuniteteve lokale (veçanërisht të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë). Më pas studentët identifikuan mundësitë për zhvillimin e zonës dhe përcaktuan prioritetet, mbi të cilat bazuan vizionet, konceptet dhe skenaret e tyre zhvillimore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të saj. Si rezultat i punëtorisë, u zhvilluan gjithsej pesë skenare zhvillimore hapësinore për zonën e projektit, secili prej tyre i përcjellë me komponentën e zhvillimit socio-ekonomik të komuniteteve të përfshira gjithashtu.



FIGURA 34. Pjesëmarrësit e punëtorisë.






FIGURA 35. Fotografi gjatë puntorisë së studentëve.






	<p>Grupi 1 “Të gjitha rrugët të dërgojnë tek lumi”</p>
	<p>Grupi 2 “Një vend i mirë për t’u rritur”</p>
<p>Diagrama Aktuale :</p> 	<p>Grupi 3 “Zemra dhe mendja e gjelbër e Mitrovicës”</p>
<p>PËR TË GJITHË</p> <p>E SIGURT</p> <p>FTUESE</p> <p>MIKPRITËSE</p> <p>DIVERSE</p> <p>ZONA GJITHËPËRFSHIRËSE</p> <p>BANIMI</p> <p>REKREIMI</p> <p>PUNA</p> 	<p>Grupi 4 “Qyteti gjithëpërfshirës”</p>
	<p>Grupi 5 “Qyteti i hapur”</p>

FIGURA 36. Vizionet e grupeve.

Grupi 1 - Të gjitha rrugët të dërgojnë tek lumi

Në Grupin 1 morrën pjesë studentët Armend Hoxha, Blerina Boshnjaku, Drenushë Ukshini, Festa Hashani dhe Granita Haxhani, të cilët u udhëheqën nga Zana Sokoli (UN-Habitat). Gjatë punës në grup, u konkludua se tangjentimi i zonës nga lumi Ibër, Liqeni Artificial dhe hapësirat e tjera të gjelbërta, por edhe prezenca e lartë e institucioneve arsimore e kulturore, i shtojnë rëndësinë zonës në raport me pjesët tjera urbane të qytetit. Megjithatë, këto vlera nuk janë të lidhura mirë me njëra-tjetrën, nuk funksionojnë si tërësi, nuk janë të theksuara dhe nuk shfrytëzohen mjaftueshëm. Për më

tepër, kanë rrezik t'i nënshtrohen një procesi të zhvillimit të pakontrolluar të tyre në të ardhmen, i cili në mungesë të marrjes parasysh të përkatësisë etnike e socio-ekonomike të ndryshme të komuniteteve nëpër lagje, ka rrezik të qojë drejt segregimit të zonës dhe getoizimit të Lagjes Rome. Rrjedhimisht, grupi ka identifikuar nevojën për rregullimin e rrjetit rrugor, krijimin e një rrjeti të ri të hapësirave publike (të cilat do të lidhnin objektet publike përmes shesheve rreth tyre), si dhe rifunksionalizimin e hapësirës së tregut. Vlerat, çështjet, mundësitë dhe prioritetet për zhvillim të lagjeve në zonën e projektit, të identifikuara nga Grupi 1 janë paraqitur në tabelat më poshtë.

Vlerat/Asetet	Kufizimet/Çështjet
<ul style="list-style-type: none"> - Prezenca e hapësirave publike; - Afërsia e lumit Ibër dhe Liqenit Artificial; - Prezenca e qendrave sportive dhe kulturore; - Prezenca e institucioneve edukativo-arsimore; - Prezenca e hapësirave ekonomike; - Afërsia me qendrën e qytetit; - Diversiteti etnik; - Përkatësia në religjione të ndryshme; - Dendësia e ulët e ndërtimit/banimit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Shkëputja në mes e hapësirave publike; - Mungesa e infrastrukturës; - Mungesa e sigurisë; - Rrjeti rrugor jo i lidhur mirë; - Segregimi etnik; - Çështjet pronësore të pazgjidhura; - Mungesa e hapësirave të gjelbërta përgjatë liqenit; - Mungesa e hapësirave përcjellëse të stadionit "Adem Jashari".

TABELA 5. Vlerat dhe kufizimet e lagjeve të identifikuara nga Grupi 1.

Mundësitë	Prioritetet
<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i hapësirave publike të ndërmjetme (lidhja apo rrjetëzimi i hapësirave publike); - Krijimi i hapësirave publike për grupmosha të ndryshme; - Rivitalizimi i rrjetit rrugor; - Përfshirja e zonës në rrjetin e ri të transportit publik; - Pasurimi i qendrave kulturore-sportive me infrastrukturë përcjellëse; - Rifunksionalizimi i hapësirës së tregut me anë të ndryshimit të politikave socio-ekonomike; - Pasurimi i infrastrukturës rrugore me elemente përcjellëse; - Inkuadrimi i institucioneve edukativo-arsimore në rrjetin e hapësirave publike. 	<ul style="list-style-type: none"> - Lidhja e qendrës së qytetit me Liqenin Artificial përmes hapësirave publike të pandërprera përgjatë rrjedhës së lumit; - Krijimi i arterieve rrugore për lidhjen e pjesëve të tjera të qytetit të Mitrovicës Jugore me lumin dhe Liqenin Artificial; - Krijimi i infrastrukturës përcjellëse dhe hapësirave publike për stadiumin "Adem Jashari"; - Krijimi i ndjenjës së përkatësisë, sigurisë, barazisë dhe integritetit.


TABELA 6. Mundësitë dhe prioritetet e lagjeve të identifikuara nga Grupi 1.

Vizioni i Grupit 1 për zonën e projektit është **“Të gjitha rrugët të dërgojnë tek lumi. Lagjet tona atraktive, të qëndrueshme dhe të hapura për të gjithë”**, i cili parasheh integrimin e komuniteteve të ndryshme në zonën e projektit, si dhe krijimin e ndjenjës së përkatësisë, sigurisë dhe barazisë. Për të arritur këtë vizion, është paraparë lidhja e të gjitha pjesëve të qytetit me lumin Ibër dhe Liqenin Artificial, trajtimi i mirëfilltë i hapësirave të gjelbërta, si dhe lidhja e hapësirave publike ekzistuese dhe të reja me njëra-tjetrën dhe me institucionet publike, kulturore e rekreative.



FIGURA 37. Skema e Vizionit të Grupit 1.

MASTERPLANI



PROJEKTI PARASHEH LIDHJEN E TË GJITHA PJESËVE TË QYTETIT TË MITROVICËS ME LUMIN DHE LIQENIN ARTIFICIAL, ASETET NATYRORE ME POTENCIAL PËR TË RRITUR ATRAKTIVITETIN E ZONËS ME ANË TË TRAJTIMIT TË MIRËFILLËT TË HAPËSIRËS SË GJELBËR NË TË DY ANËT E SAJ. I PASUR EDHE ME NJË NUMËR TË MADHË TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE DHE QENDRAVE KULTURORE E SPORTIVE, PROJEKTI PARASHEH KRIJIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE TË TYRE DHE LIDHJEN E TYRE TË MIRËFILLËT.

LEGJENDA:

- NDËRTESA PUBLIKE
- BANIM I PËRBALLUESHËM
- ARTERIE KRYSORE TË KOMUNIKACIONIT RRUGOR
- LIDHJA E HAPËSIRAVE PUBLIKE
- LIDHJA E DY ANËVE TË LUMIT

FIGURA 38. Masterplani i propozuar nga Grupi 1.

Grupi 2 - Një vend i mirë për t'u rritur

Në Grupin 2 morrën pjesë studentët Albina Krasniqi, Elsa Kameri, Endrit Haliti, Gëzim Rushiti dhe Lirikë Gashi, të cilët u udhëheqën nga Fjollë Caka (UN-Habitat). Bazuar në vizitat në terren, takimet me palët e interesit, si dhe të gjeturat paraprake dhe gjatë punëtorisë, studentët vlerësuan se pozita gjeografike e zonës

së projektit (përbrenda zonës urbane), llojllojshmëria e përmbajtjeve të saj (arsimore, ekonomike, kulturore e rekreative), si dhe diversiteti i komuniteteve krijojnë potencial për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithpërfshirës të saj. Vlerat, çështjet, mundësitë dhe prioritetet për zhvillim të lagjeve në zonën e projektit, të cilat Grupi 2 i identifikoi gjatë punëtorisë janë paraqitur në vijim.

Vlerat/Asetet	Kufizimet/Çështjet
<ul style="list-style-type: none"> - Prezenca e lumit Ibër dhe Liqenit Artificial; - Prezenca e stadimeve dhe fushave sportive; - Prezenca e institucioneve arsimore; - Prezenca e pishinës Aqua Park dhe OMNI Sport; - Prezenca e Tregut të Gjelbër; - Prezenca e komunës dhe qendrës kulturore; - Diversiteti demografik; - Prezenca e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Lagjen Rome; - Hapësira të lira dhe parqe. 	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e lidhjes në mes liqenit akumulues dhe shetitores në qendër; - Infrastruktura e dobët dhe mungesa e mirëmbajtjes; - Mosfunksionimi i tregut, rreziku i shëndetit publik, mungesa e kushteve, mungesa e vetëdijesimit; - Menaxhimi i dobët i mbeturinave dhe ndotja e ambientit; - Rrjeti rrugor nuk funksionon mirë, mungesa e ndriqimit publik, shportave të mbeturinave; - Mos-integritimi në shoqëri, diskriminimi, shkelja e të drejtave të komuniteteve të marginalizuara; - Mirëmbajtja e dobët e hapësirave publike dhe mungesa e inventarit urban.

TABELA 7. Vlerat dhe kufizimet e lagjeve të identifikuara nga Grupi 2.

Mundësitë	Prioritetet
<ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i shetitores dhe i hapësirave përcjellëse, mirëmbajtja e gjelbërimit ekzistues dhe mbjellja e gjelbërimit (të lartë); - Përmirësimi i infrastrukturës rrugore (përfshirë trotualet, shtigjet e çiklistëve, si dhe qasja për persona me aftësi të kufizuara); - Rivitalizimi i Tregut të Gjelbër – përmirësimi i dizajnit urban, rritja e kapacitetit, dhe rritja e konkurrencës; - Menaxhimi i hapësirave publike; - Menaxhimi i mbeturinave; - Programi për riciklim; - Integrimi i komuniteteve të lagjeve përmes dizajnit urban dhe aktiviteteve. 	<ul style="list-style-type: none"> - Përmirësimi i infrastrukturës rrugore - krijimi i shtigjeve për çiklistë dhe ndriqimit publik, si dhe rregullimi i mobilitetit (ngritja e zhvillimit ekonomik); - Rivitalizimi i hapësirave publike dhe ndërlidhja e tyre, si dhe shtimi i hapësirave publike, hapësirave të gjelbërta dhe rekreative (ngritja e zhvillimit ekonomik dhe e integritit shoqëror); - Integrimi i komuniteteve Rome, Ashkali dhe Egjiptas përmes përmirësimit të mirëqenies njerzore; - Zgjidhja e çështjes së tregut, krijimi i hapësirës multifunksionale, shtimi i atraktivitetit përmes dizajnit urban dhe ofertave të përshtatshme ekonomike; - Krijimi i mini-tregjeve në lagjet e mëdha.

TABELA 8. Mundësitë dhe prioritetet e lagjeve të identifikuara nga Grupi 2.

Vizioni i Grupit 2 është për të krijuar **“Një vend të mirë për t’u rritur!”** Përkatësisht, synohet zhvillimi i një zone urbane lehtë të qasshme, të depërtueshme, të ecshme dhe të sigurt; me rrjet të hapësirave publike të gjelbërta, të mirëmbajtura dhe të lidhura mirë me lumin Ibër; me institucione arsimore proaktive; e cila ofron aktivitete socio-ekonomike për të gjithë qytetarët pa dallim. Disa nga propozimet e grupit përfshijnë përzierjen e funksioneve (banim dhe afarizëm) në pjesën më të madhe të lagjeve (përveç hapësirave të gjelbërta dhe atyre arsimore), rifunksionalizimin e Tregut të Gjelbër dhe përmirësimin e strukturës urbane në Lagjen Rome.



FIGURA 39. Skema e vizionit të Grupit 2.




FIGURA 40. Masterplani i propozuar nga Grupi 2.

Grupi 3 - Zemra dhe mendja e gjelbër e Mitrovicës

Në Grupin 3 morrën pjesë studentët Besjana Kurti, Elira Bushati, Fisnik Abrashi dhe Leonard Bllaca, të cilët u udhëheqën nga Modest Gashi (UN-Habitat) dhe Shqipërim Ahmeti (Kolegji UBT). Gjatë punës në grup, Grupi 3 identifikoi

